



**Thirrja Publike për mbështetje financiare publike për financimin e Projekteve /  
Programeve të OJQ-ve: që kontribuojnë në zbatimin e Planit të Veprimit Lokal për  
Rini 2018 – 2020 të Komunës së Gjakovës**

## **Udhëzimet për Aplikantët**

Data e hapjes së Thirrjes: 31.05.2018  
Afati i fundit për dorëzimin e aplikacioneve: 20.06.2018

**KOMUNA E GJAKOVËS**

**DREJTORIA E KULTURËS RINISË DHE SPORTIT**

Postal address: Nëna Terezë – Gjakovë, Kosovë / 50000 Tel: +381 390 322 591

[kk.rks-gov.net/gjakove/](http://kk.rks-gov.net/gjakove/)

## PËRMBAJTJA:

- MBËSHËTETJE FINANCIARE PËR PROJEKTET E OJQ-ve NË ZHVILLIMIN DHE AVANCIMIN E FUSHËS SË RINISË NË KOMUNËN E GJAKOVËS
  - Problemet të cilat synohet të adresohen përmes kësaj Thirrje Publike
    - 1.2 Objektivat e Thirrjes dhe Prioritetet për ndarjen e fondeve
  - 1.3 Vlera e planifikuar e mbështetjes financiare për projektet dhe totali i thirrjes
    - 2. KUSHTET FORMALE TË THIRRJES
      - 2.1. Aplikuesit e pranueshëm: kush mund të aplikoj?
      - 2.2 Partnerët e pranueshme në zbatimin e Projektit / Programit
      - 2.3 Aktivitetet e pranueshme që do të financohen përmes thirrjes
      - 2.4 Shpenzimet e pranueshme që do të financohen përmes thirrjes
        - 2.4.1 Shpenzimet e drejtpërdrejta të pranueshme
        - 2.4.2 Shpenzimet e tërthorta të pranueshme
        - 2.4.3 Shpenzimet e papranueshme
    - 3. SI TË APLIKONI ?
      - 3.1 Forma e përshkruese e projekt propozimit
        - 3.2 Përmbajtja e formës Buxhetit
        - 3.3 Ku ta dorëzoni aplikimin?
      - 3.4 Afati i fundit për dërgimin e aplikacioneve
      - 3.5 Si të kontaktoni nëse keni ndonjë pyetje?
    - 4. VLERËSIMI DHE NDARJA E FONDEVE
      - 4.1 Aplikacionet e pranuar do të kalojnë nëpër procedurën e mëposhtme:
        - 4.2 Dokumentacion shtesë dhe Kontraktimi
    - 5. KALENDARI INDIKATIV I REALIZIMIT TË THIRRJES
    - 6. LISTA E DOKUMENTEVE TË THIRRJES PUBLIKE

**Thirrje publike për ofrimin e mbështetjes financiare publike për financimin e  
Projekteve / Programeve të OJQ-ve:**  
që kontribuojnë në zbatimin e Planit të Veprimit Lokal për Rini 2018 – 2020 të Komunës së Gjakovës.

## 1.1 PROBLEMET TË CILAT SYNOHET TË ADRESOHEN PËRMES KËSAJ THIRRJE PUBLIKE

1.1.1. Të gjitha OJQ-të në Komunën e Gjakovës, programi i punës i të cilave është i fokusuar në fushën e Rinisë.

1.1.1 Në Kosovë ekzistojnë një numër i madh i Organizatave Jo Qeveritare të cilat merren me promovimin e vetëdijesimit të qytetarëve në bashkëpunimin e sektorit privat me Komunën e Gjakovës. Prandaj, edhe kjo thirrje publike për përkrahje të projekteve të Organizatave Joqeveritare të cilat në programin e tyre janë të fokusuar në fushën e Rinisë, e ideve kreative për të promovuar rritjen e bashkëpunimit të Komunës me sektorin privat, bizneseve dhe OJQ-të.

## 1.2 OBJEKTIVAT E THIRRES DHE PRIORITETET PËR NDARJEN E FONDEVE

Objekti/objektivat e përgjithshme të kësaj Thirrje është / janë:

Përbushja e objektivave të DKRS-se të bazuara në planin e punës 2018 që ndërlidhen me fushën e Rinisë. Avancimi i Rinisë dhe ngritja e vlerave Rinore dhe aktivizimi i shoqërisë civile përmes organizmit të aktiviteteve të cilat ndihmojnë arritjen e objektivave.

Objektivat specifike të kësaj Thirrje janë:

1. Të gjitha OJQ-të në Komunën e Gjakovës, programi i punës i të cilave është i fokusuar në fushën e Rinisë.
2. Objekti i kësaj Thirrje për Propozime është: Përmirësimi i aftësisë së OJQ-ve për të promovuar partneritetin dhe bashkëpunimin e Organizatave Jo-Qeveritare me institucionet lokale, institucionet që veprojnë në fushën e promovimit të bashkëpunimit të Komunës së Gjakovës me Sektorin e Rinisë me biznese dhe OJQ-të.

Prioritet për ofrimin e mbështetjes financiare publike do të kenë:

- ✓ Promovimi i pjesëmarrjes së të rinjve në proceset e vendimmarrjes;
- ✓ Përkrahje në fushën e edukimit jo-formal.
- ✓ Promovimi i punës vullnetare dhe punës praktike;
- ✓ Promovimi i mjedisit të sigurt dhe parandalimi i sjelljeve të rrezikshme; dhe
- ✓ Promovimi i barazisë gjinore, mos-diskriminimit dhe integritetit shoqëror.

### 1.3 VLERA E PLANIFIKUAR E MBËSHTETJES FINANCIARE PËR PROJEKTET DHE TOTALI I THIRRJES

1. Shuma minimale e mbështetjes financiare që mund të alokohet për çdo projekt individual është 250.00 Euro.
  2. Projektet mund të financohen në shumën 80 % të totalit të kostove të pranueshme të projektit.
- Aplikantët dhe partnerët potencialë është nevojshme të sigurojnë bashkëfinancim nga burimet tjera (publike ose private) të financimit.].

## 2. KUSHTET FORMALE TË THIRRJES

### 2.1. Aplikuesit e pranueshëm: Kush Mund të Aplikoj?

OJQ-të aplikuese të jenë të regjistruara në Ministrinë e Administratës Publike - (për të dëshmuar këtë kërkesë,

OJQ-ja aplikuese duhet të dërgoj kopjen e certifikatës së regjistrimit me rastin e aplikimit.

Të jetë e pajisur me Numër Fiskal – të lëshuar nga Administrata Tatimore e Kosovës. Me rastin e aplikimit

OJQ- duhet të dëshmojë këtë kërkesë përmes kopjes së certifikatës së numrit fiskal.

OJQ-të aplikuese duhet të kenë kryer të gjitha detyrimet tatimore ndaj ATK-së. Ndonëse mund të ketë detyrime të pashlyera në momentin e aplikimit, OJQ-ja që përfiton nga fondet publike para nënshkrimit të kontratës duhet të dëshmojë se ose ka kryer obligimet tatimore ose ka arritur ndonjë marrëveshje me ATK-në për kryerjen e tyre në të ardhmen. Ekzistenca e borxheve dhe obligimeve tjera të pashlyera nuk guxon të ndikoj në implementimin e projektit, prandaj, zgjidhja e çfarëdo detyrimi të tillë para nënshkrimit të kontratës është e domosdoshme. OJQ-ja aplikuese nuk duhet të ketë pranuar mjete financiare për realizimin e të njëjtave aktivitete në vitin përkatës fiskal. Prandaj, me rastin e aplikimit kërkohet një deklaratë e cila e shmangë financimin e dyfishtë për aktivitetet e njëjta.

Të kenë dorëzuar një projekt propozim sipas formularit e aplikacionit të projektit/programit Formulari F9 së bashku me formularin e propozim buxhetit sipas formularit F10.

Komisioni Vlerësues i Ofruesit të mbështetjes financiare varësisht nga kushtet dhe kërkesat e thirrjes publike përmbushjen e kriterëve formale do të bëjë një vlerësim formal të dokumentacionit të dorëzuar nga aplikuesit. Përmbushja e kriterëve formale nënkupton dorëzimin brenda afatit të thirrjes të një aplikimi me projekt propozim, së bashku me dokumentet e kërkuara përmes thirrjes.

Disa nga dokumentet kryesore të cilat Ofruesi i mbështetjes financiare varësisht nga thirrja publike do të kërkojë të dorëzohen nga OJQ-të përfshijnë:

1. Certifikata e regjistrimit të OJQ-së (Obligative)
2. Certifikatën e numrit fiskal (Obligative)
3. Vërtetim mbi kryerjen e të gjitha detyrimeve tatimore, i cili duhet të dorëzohet komisionit vlerësues para publikimit të rezultateve përfundimtare (pas publikimit të rezultateve preliminare të përfituesve) (Obligative).
4. Të ketë dorëzuar projekt propozimin të plotësuar në formatin e aplikacionit sipas kërkesave të thirrjes publike (Obligative)

5. Të ketë dorëzuar propozimin e buxhetit në formatin sipas kërkesave të thirrjes dhe të plotësuar në tërësi (Obligative)
6. Deklaratë e nënshkruar se për të njëjtin projekt nuk është pranuar financim i dyfishtë nga burimet tjera (Obligative)
7. Deklaratë se OJQ ka përgatitur dhe dorëzuar pasqyrat financiare vjetore (nëse kërkohet sipas thirrjes)
8. Një deklaratë me të cilën tregojnë se i kanë përmbushur detyrimet nga mbështetjet financiare publike të mëhershme (nëse kërkohet sipas thirrjes)
9. Të dorëzoj deklaratat e partneritetit në rastet kur propozohet implementimi i projekteve në partneritet; (nëse kërkohet sipas thirrjes)
10. Të dorëzoj CV të menaxherit të projektit (nëse kërkohet sipas thirrjes)
11. Të dërgojë dëshmi të implementimit të projekteve/ programeve të ngjashme (nëse kërkohet sipas thirrjes)

## 2.2 Partnerët e pranueshme në zbatimin e Projektit / Programit:

Organizatat Jo Qeveritare të komunës së Gjakovës të cilat plotësojnë dokumentacionin e kërkuar sikurse të aplikantit kryesore.

## 2.3 Aktivitetet e pranueshme që do të financohen përmes thirrjes:

1. Periudha kohore e zbatimit të projektit: Brenda Vitit;
2. Lokacioni zbatimit të aktivitetit, kryesisht do të zbatohet në lokacionin e Komunës së Gjakovës;
3. Lista e aktiviteteve që do të përfshihen:

- ✓ Aktivitetet që kanë për qëllim nxitjen e autoriteteve lokale, institucioneve publike dhe akterëve tjerë për bashkëpunim me shoqërinë civile me qëllim ruajtjen, ngritjen, nxitjen dhe përcjelljen e frymës Rinore tek shoqëria civile e më gjë;
- ✓ Promovimi i pjesëmarrjes së të rinjve në proceset e vendimmarrjes.
- ✓ Përkrahje në fushën e edukimit jo-formal;
- ✓ Promovimi i punës vullnetare dhe punës praktike;
- ✓ Promovimi i mjedisit të sigurtë dhe parandalimi i sjelljeve të rrezikshme; dhe
- ✓ Promovimi i barazisë gjinore, mos-diskriminimit dhe integritit shoqëror

Lista e aktiviteteve të projektit nuk është e mbyllur, por vetëm e ilustruar dhe do të merren parasysh për financim edhe aktivitete tjera të përshtatshme që kontribuojnë në arritjen e objektivave të përgjithshme dhe specifike të thirrjes, të cilat nuk janë të përmendura në listën më lartë.

Gjatë zbatimit të aktiviteteve të projektit, aplikanti duhet të sigurojë që bazohet në parimin e ofrimit të mundësive të barabarta, barazisë gjinore dhe jo-diskriminimit, si dhe të zhvillojë veprimtari në përputhje me nevojat e komunitetit dhe qytetarëve.

## 2.4 Shpenzimet e pranueshme që do të financohen përmes thirrjes:

Përmes fondeve publike të kësaj thirrje publike mund të financohen vetëm kostot reale dhe të pranueshme për realizimin e aktiviteteve të projektit, në periudhën kohore të specifikuar me këto udhëzime. Në vlerësimin e projektit / programit do të vlerësohen vetëm kostot e nevojave në lidhje me aktivitetet e planifikuara, si dhe në lartësinë reale të këtyre shpenzimeve

### 2.4.1 Shpenzimet e tërthorta të Pranueshme

Përveç shpenzime të pranueshme direkte, në kuadër të kësaj thirrje do të pranohen edhe kostot indirekte (përqindje e vlerës totale të projektit/programit. Në kuadër të këtyre shpenzimeve përfshihen kostot që nuk janë të lidhura direkt me zbatimin e projektit ose programit, por janë kosto që në mënyrë të tërthortë kontribuojë në arritjen e objektivave të projektit. Edhe këto kosto duhet të specifikohen dhe të shpjegohen.

## 3. SI TË APLIKONI ?

Aplikimi i OJQ-ve do të konsiderohet i plotë nëse përmban të gjitha format e aplikimit dhe anekset e detyrueshme siç kërkohet në thirrjen publike dhe dokumentacionin e thirrjes si në vijim:

### 3.1 Aplikacioni i projekt propozimit

Plotësimi i formularit të projekt propozimit është pjesë e dokumentacionit të detyrueshëm. Ajo përmban të dhëna në lidhje me aplikusin dhe partnerët si dhe të dhëna mbi përmbajtjen e projektit/programit për të cilin kërkohet financim nga burimet publike. Në rast se në formën e dorëzuar mungojnë të dhënat në lidhje me përmbajtjen e projektit, aplikimi nuk do të merret në konsideratë. Forma është e nevojshme të plotësohet me kompjuter. Nëse forma është plotësuar me dorë nuk do të merren në konsideratë. Nëse forma përshkruese përmban të meta si më sipër, aplikimi do të konsiderohet i pavlefshëm.

### 3.2 Përmbajtja e formës Buxhetit

Formulari i propozim Buxhetit është pjesë e dokumentacionit të detyrueshëm. Propozim Buxheti i dorëzuar duhet të përmbaj informacion për të gjitha shpenzimet direkte dhe indirekte të projektit/programit të propozuar për financim.

Nëse forma e buxhetit nuk është e plotësuar në tërësi, apo nuk është dorëzuar në formën përkatëse aplikimi nuk do të merret në konsideratë

Forma është e nevojshme të plotësohet me kompjuter. Nëse forma është plotësuar me dorë nuk do të merret në konsideratë.

### 3.3 Ku ta dorëzoni aplikimin ?

Format e detyrueshme dhe dokumentacioni i kërkuar duhet të dërgohen në formë fizike, të shtypur (një origjinal) dhe në formë elektronike (në CD). Format e detyrueshme duhet të jenë të nënshkruara nga përfaqësuesi i autorizuar dhe të vulosura me vulën zyrtare të organizatës. Dokumentacioni në formë elektronike (në CD) duhet të ketë të njëjtën përmbajtje, pra të jetë identik me versionin e shtypur. Dokumentacioni i shtypur dhe ai elektronik në CD duhet të vendosen në një zarf të mbyllur.

Aplikimi origjinal duhet të dërgohet me postë ose në person (dhe të dorëzohet në Zyrën e DKRS-së). Në pjesën e jashtme të zarfit duhet të shënohet emri i thirrjes publike, së bashku me emrin e plotë dhe adresën e aplikuesit dhe shënimin:

**"Të mos të hapet para takimit të Komisionit Vlerësues".**

### 3.4 Afati i fundit për dërgimin e aplikacioneve:

Afati i thirrjes është 31.05.2018 – 20.06.2018 dhe është dorëzuar brenda periudhës së thirrjes nëse vula pranuese tregon se është marrë në postë deri në fund të datës së thirrjes, si afati i fundit për dorëzimin. Në rast se kërkesa është paraqitur personalisht në Zyrë, aplikantit do t'i lëshohet një vërtetim se aplikacioni është pranuar brenda periudhës së konkursit.

Të gjitha aplikacionet e dërguara pas afatit nuk do të merren parasysh.

### 3.5 Si të kontaktoni nëse keni ndonjë pyetje?

Të gjitha pyetjet në lidhje me thirrjen mund të bëhen në zyrat e DKRS-së.

## 4. VLERËSIMI DHE NDARJA E FONDEVE

### 4.1 Aplikacionet e pranuar do të kalojnë nëpër procedurën e mëposhtme:

4.1.1 Ofruesi i mbështetjes financiare do të themeloj një komision vlerësues të përbërë nga 5 anëtarë nga zyrtar të institucionit dhe ekspert tjerë të jashtëm, i cili ka për detyrë të vlerësoj aplikacionet nëse i plotësojnë kushtet formale të thirrjes publike.

Pas kontrollimit të gjitha aplikacioneve të pranuar, komisioni do të përgatis një listë të të gjitha aplikantëve që i plotësojnë kushtet për tu vlerësuar përmbajtja e projekteve të tyre, dhe një listë të aplikantëve të cilët nuk i plotësojnë kushtet e përcaktuara të konkurrencës. Ofruesi i mbështetjes financiare do të njoftojë me shkrim të gjithë aplikantët të cilët nuk i plotësojnë kërkesat dhe arsyet e refuzimit të aplikimit të tyre.

4.1.2 Në fazën e dytë do të bëhet vlerësimi i përmbajtjes së aplikimeve nga ana e Komisionit vlerësues i përbërë nga 5 anëtarë. Çdo aplikacion i pranuar do të vlerësohet në bazë të formularit të vlerësimit

Lista e përkohshme e projekteve/programeve përfituese të përzgjedhura për financim - Në bazë të vlerësimit të aplikacioneve të cilat i kanë plotësuar kushtet e parashikuara të thirrjes, Komisioni do të hartojë një listë të përkohshme të projekteve/programeve të përzgjedhura, sipas pikëve që ata kanë marrë në procesin e vlerësimit.

Krahas listës së përkohshme, bazuar në pikat që janë bërë gjatë vlerësimit, Komisioni do të hartojë edhe listën rezervë të projekteve/programeve.

## 4.2 Dokumentacion shtesë dhe Kontraktimi

Për të shmangur shpenzimet e panevojshme shtesë kur të aplikoni për konkurrencën, një ofrues i burimeve financiare do të kërkojë dokumentacion shtesë vetëm nga ata aplikantë të cilët, në bazë të procesit të vlerësimit të aplikacioneve, ka hyrë në listën e përkohshme të projekteve/programave të përzgjedhura për financim.

Para nënshkrimit përfundimtar të kontratës, dhe në bazë të vlerësimit të Komisionit, ofruesi mund të kërkojë shqyrtimin e formës së buxhetit për kostot e vlerësuara që korrespondojnë me shpenzimet aktuale në lidhje me aktivitetet e propozuara.

Nëse aplikuesi nuk paraqet dokumentacionin e kërkuar shtesë brenda kohës së caktuar (jo më pak se 10 ditë), aplikimi do të refuzohet.

Nëse pas kontrollimit të dokumenteve mbështetëse vendoset se disa nga aplikuesit nuk i plotësojnë kushtet e kërkuara të thirrjes publike, nuk do të merret në konsideratë për nënshkrim të kontratës.

Në raste të tilla, projektet nga lista rezervë do të aktivizohen nëse, pas kontrollimit të dokumenteve mbështetëse dhe pasi të konstatohet nga institucioni se ka mjete të mjaftueshme për të kontraktuar projekte të tjera.

Njoftimi i aplikuesve - Të gjithë aplikantët aplikimet e të cilëve kanë hyrë në procesin e vlerësimit do të jenë të informuar në lidhje me vendimin për ndarjen e projekteve/programave në kuadër të thirrjes

## 5. KALENDARI INDIKATIV I REALIZIMIT TË THIRRJES

Fazat e procedurës së thirrjes (vendosni datat):

1. Afati i fundit për aplikimet : 20.06.2018 / 16:00h
2. Afati i fundit për dërgimin e pyetjeve në lidhje me thirrjen : 20.06.2018 / 16:00h
3. Afati i fundit për dërgimin e përgjigjeve për pyetjet që lidhen me thirrjen : 20.06.2018 / 16:00h
4. Afati i fundit për verifikimin e përmbushjes së kriteve procedurale dhe njoftimit të palëve: 20.06.2018 / 16:00h
5. Afati i fundit për vlerësimin e aplikimeve në mënyrë përmbajtësore: 20.06.2018 / 16:00h
6. Afati i fundit për kërkesën për dorëzimin e dokumenteve shtesë: 20.06.2018 / 16:00h
7. Afati i fundit për dorëzimin e dokumentacionit të kërkuar: 20.06.2018 / 16:00h

Financuesi ka të drejtë të përditësoj kalendarin indikativ. Duhet të dini se çdo ndryshim në kalendarin indikativ do të publikohet në faqen e internetit e mëposhtme: [kk.rks-gov.net/gjakove/](http://kk.rks-gov.net/gjakove/)

## 6. LISTA E DOKUMENTEVE TË THIRRJES PUBLIKE

Formulari i Udhëzimit për Aplikantë

Formulari i Aplikacionit për projekt/programit (word)

Formulari i Propozim buxhetit (format excel)

Formulari i deklaratës për financim të dyfishtë (format Word)

Formulari i deklaratave të partneritetit (format Word)

Formulari i deklaratës së projekteve të financuara (format Word)

Formulari i deklaratës mbi aktivitetet e përshkruara për kontraktoret (format Word)

Formulari i raportit të përshkruar të projektit (format Word)

Formulari i Raportit Financiar (formatin word/excel)

Formulari i raportit narrativ – përshkrues (format word)